

32001R2580

RREGULLORJA E KËSHILLIT (KE) NR. 2580/2001, DATË 27 DHJETOR 2001, "PËR MASAT SPECIFIKE KUFIZUESE NDAJ PERSONAVE DHE SUBJEKTEVE TË CAKTUARA, ME SYNIMIN PËR TË LUFTUAR TERRORIZMIN"

Gazeta Zyrtare L 344, 28.12.2001 F. 0070 - 0075

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Evropian dhe në veçanti nenet 60, 301 dhe 308 të tij,

Duke pasur parasysh Qëndrimin e Përbashkët 2001/931/PPJS, "Për aplikimin e masave specifike në luftën kundër terrorizmit¹, të miratuar nga Këshilli më 27 dhjetor 2001,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Evropian²,

Meqë:

1. Këshilli Evropian, në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme të 21 shtatorit 2001, deklaroi se terrorizmi është një sfidë e vërtetë për botën dhe Evropën dhe se lufta kundër terrorizmit do të jetë një nga objektivat kryesorë të Bashkimit Evropian.

2. Këshilli Evropian deklaroi se lufta kundër financimit të terrorizmit është një aspekt vendimtar i luftës kundër terrorizmit dhe i bëri thirrje Këshillit që të marrë masat e nevojshme për luftën kundër çdo forme të financimit të aktiviteteve terroriste.

3. Në rezolutën e tij 1373(2001), Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara vendosi, më 28 shtator 2001, se të gjitha shtetet duhet të ngrinin fondet dhe aktivet e tjera financiare ose burimet ekonomike të personave që kryejnë ose përpiqen të kryejnë akte terroriste apo që marrin pjesë ose ndihmojnë në kryerjen e këtyre akteve.

4. Po ashtu, Këshilli i Sigurimit vendosi se duhet të merren masa për ndalimin e vënies në dispozicion të fondeve dhe të aktiveve financiare apo burimeve të tjera ekonomike në përfitim të këtyre personave, si dhe për ndalimin e ofrimit të shërbimeve financiare ose shërbimeve të lidhura në përfitim të këtyre personave.

5. Nevojitet ndërhyrja e BE-së për zbatimin e aspekteve PPJS të Qëndrimit të Përbashkët 2001/931/PPJS.

6. Kjo rregullore është një masë e nevojshme në nivelin e BE-së dhe plotëson procedurat administrative dhe gjyqësore në lidhje me organizatat terroriste në Bashkimin Evropian dhe në vendet e treta.

7. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, territori i BE-së përfshin të gjitha territoret e shteteve anëtare në të cilat zbatohet traktati, sipas kushteve të përcaktuara në atë traktat.

8. Me qëllim mbrojtjen e interesave të Be-së, mund të bëhen disa përjashtime.

9. Për sa i përket procedurës për krijimin dhe ndryshimin e listës së përmendur në nenin 2, paragrafi 3 të kësaj rregulloreje, Këshilli duhet të ushtrojë vetë kompetencat zbatuese përkatëse duke marrë në konsideratë masat specifike që disponojnë shtetet anëtare për këtë qëllim.

10. Shmangia nga kjo rregullore duhet të ndalohet me ndihmën e një sistemi të përshtatshëm informimi dhe, sipas rastit, masave korrigjuese, duke përfshirë legjislacionin shtesë të BE-së.

11. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare duhet, kur është e nevojshme, të kenë kompetenca për të garantuar përputhshmërinë me dispozitat e kësaj rregulloreje.

12. Shtetet anëtare duhet të përcaktojnë rregullat për sanksionet e zbatueshme për shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të sigurohen që ato të zbatohen. Këto sanksione duhet të jenë efikase, proporcionale dhe shtrënguese.

13. Komisioni dhe shtetet anëtare informojnë njëri-tjetrin për masat e marra sipas kësaj rregulloreje dhe për çdo informacion tjetër përkatës që disponojnë në lidhje me të.

14 Lista e përmendur në nenin 2, paragrafi 3 të kësaj Rregulloreje mund të përfshijë persona dhe subjekte të lidhura me shtetet e treta, si dhe të gjithë personat e tjerë që janë në fokus të aspekteve PPJS të Qëndrimit të Përbashkët 2001/931/PPJS. Për miratimin e dispozitave të kësaj rregulloreje në lidhje me këtë të fundit, traktati nuk parashikon kompetenca të tjera përveç atyre të përcaktuara në nenin 308.

15. Komuniteti Evropian ka vënë tashmë në zbatim Rezolutat 1267(1999) dhe 1333(2000) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara duke miratuar Rregulloren (KE) nr. 467/2001³ "Për ngrirjen e pasurive të personave dhe grupeve të caktuara dhe për rrjedhjet të personave dhe grupeve që nuk mbulohen nga kjo rregullore",

MIRATON KËTË RREGULLORE:

Neni 1

Për qëllimin e kësaj rregulloreje përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. "Fonde, aktive financiare dhe burime të tjera ekonomike" janë aktivet e çfarëdolloji, të trupëzuara ose të patrupëzuara, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht mënyrës së fitimit, si dhe dokumentet ligjore apo instrumentet e çfarëdo forme, përfshirë ato elektronike ose dixhitale, që provojnë të drejtat ose interesat mbi këto aktive, duke përfshirë pa kufizim kreditë bankare, çeqet bankare ose të udhëtarëve, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, pagesat, letërkreditet.

2. "Ngrirje e fondeve, aktiveve financiare dhe burimeve të tjera ekonomike" është ndalimi i çdo lëvizjeje, transferimi, tjetërsimi, përdorimi ose transaksioni të fondeve në një mënyrë që mund të shkaktojë ndryshim në vëllimin, sasinë, vendndodhjen, pronësinë, zotërimin, natyrën, destinacionin ose ndonjë ndryshim tjetër që mund bëjë të mundur përdorimin e fondeve, përfshirë administrimin e portofolit.

3. "Shërbime financiare" janë të gjitha shërbimet me natyrë financiare, përfshirë të gjitha shërbimet e sigurimit dhe në lidhje me të, si dhe të gjitha shërbimet bankare dhe shërbimet e tjera financiare (përveç sigurimit) si më poshtë:

Shërbimet e sigurimit dhe shërbimet e lidhura

I. Sigurimi i drejtpërdrejtë (përfshirë bashkësigurimin):

a) sigurimi i jetës;

b) sigurimi i jojetës;

II. Risigurimi dhe retrocesioni;

III. Ndërmjetësimi në sigurim, si brokerimi dhe shërbimet e agjentëve të sigurimit;

IV. Shërbimet ndihmëse të sigurimit, si shërbimet e konsulencës, aktuariale, të vlerësimit të rrezikut dhe të pagesës së pretendimeve.

Shërbimet bankare dhe shërbime të tjera financiare (përveç sigurimit)

V. Pranimi i depozitave dhe fondeve të tjera të shlyeshme;

VI. Të gjitha llojet e huadhënies, duke përfshirë kredinë konsumatore, kredinë hipotekore, faktoringun dhe financimin e transaksioneve tregtare;

VII. Leasing financiar;

VIII. Të gjitha shërbimet e pagesës dhe të transferimit të parave, duke përfshirë kartat e kreditit, debitit dhe pagesave, çeqet e udhëtarëve dhe draftet bankare;

IX. Garancitë dhe angazhimet;

X. Tregtimi për llogari të vet ose për llogari të klientëve, në bursë, tregje mbi banak ose tjetër, i elementeve të mëposhtme:

a) instrumentet e tregut të parasë (përfshirë çeqet, faturat, certifikatat e depozitave etj.);

b) këmbimi valutor;

c) derivatet, duke përfshirë por pa u kufizuar në kontratat future dhe opsione;

d) instrumentet e kursit të këmbimit dhe të normës së interesit, duke përfshirë produkte si kontratat swap dhe kontratat forward;

e) titujt e transferueshëm;

f) të tjera instrumente dhe aktive financiare të negociueshme, duke përfshirë kallëpet e arit;

XI. Pjesëmarrja në emetimet e të gjitha llojeve të titujve, duke përfshirë nënshkrimin dhe vendosjen si agjent (qoftë publik ose privat) dhe ofrimin e shërbimeve në lidhje me këto emetime;

XII. Ndërmjetësimi në tregun e parasë;

XIII. Administrimi i aktiveve, të tilla si administrimi i parave dhe i portofolit, të gjitha format e administrimit të investimeve kolektive, administrimi i fondeve të pensionit dhe shërbimet e marrjes në kujdestari, shërbimet depozituese dhe shërbimet e besimit;

XIV. Shërbimet e shlyerjes dhe klerimit për aktivet financiare, duke përfshirë letrat me vlerë, produktet derivative dhe instrumente të tjera të negociueshme;

XV. Ofrimi dhe transferimi i informacionit financiar dhe përpunimi i të dhënave financiare dhe ofrimi i softuerit përkatës nga ofrues të shërbimeve të tjera financiare;

XVI. Shërbimet e këshillimit, ndërmjetësimit dhe të tjera shërbime financiare ndihmëse në lidhje me të gjitha aktivitetet e renditura në nënparagrafët V deri në XV, duke përfshirë shërbimet e referencës dhe të analizës për kredinë, kërkimit dhe këshillimit mbi investimet dhe portofolin, si dhe shërbimet e këshillimit për blerjen, ristrukturimin dhe strategjitë e korporatave.

4. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, përkufizimi "akt terrorist" është akti sipas nenit 1, paragrafi 3 të Qëndrimit të Përbashkët 2001/931/PPJS.

5. "Zotërim i një personi juridik, grupi ose subjekti" është zotërimi i 50% të të drejtave të pronësisë së një personi juridik, grupi ose subjekti, ose zotërimi i shumicës së aksioneve të tyre.

6. "Kontroll i një personi juridik, grupi ose subjekti" është cilido nga rastet e mëposhtme:

a) zotërimi i të drejtës për të emëruar ose shkarkuar një pjesë të madhe të anëtarëve të organeve administrative, menaxhuese ose mbikëqyrëse të një personi juridik, grupi ose subjekti të tillë;

b) emërimi, duke ushtruar vetëm të drejtat e tij të votës, i pjesës më të madhe të anëtarëve të organeve administrative, menaxhuese ose mbikëqyrëse të një personi juridik, grupi ose subjekti të cilët e kanë marrë detyrën gjatë vitit financiar aktual ose atij pararendës;

c) kontrolli absolut, sipas një marrëveshjeje me aksionarë ose anëtarë të tjerë të atij personi juridik, grupi ose subjekti, i shumicës së të drejtave të votës të aksionarëve ose anëtarëve të atij personi juridik, grupi ose subjekti;

d) e drejta për të ushtruar ndikim dominues mbi një person juridik, grup ose subjekt, në zbatim të një kontrate të lidhur me personin juridik, grupin ose subjektin në fjalë ose ndonjë dispozite të aktit të themelimit ose statutit, kur ligji që rregullon këtë person juridik, grup ose subjekt lejon që ai t'u nënshtrohet kontratave apo dispozitave të tilla;

e) kompetenca për ushtruar një ndikim dominues sipas germës "d", pa qenë zotërues asaj të drejte;

f) e drejta për të përdorur të gjitha ose një pjesë të pasurive të një personi juridik, grupi ose subjekti;

g) menaxhimi i biznesit të një personi juridik, grupi ose subjekti mbi baza të unifikuara, duke publikuar llogari të konsoliduara;

h) pjesëmarrja, bashkërisht ose individualisht, në pasivet financiare të një personi juridik, grupi ose subjekti, ose garantimi i tyre.

Neni 2

1. Përveç siç lejohet nga neni 5 dhe 6:

a) ngrihen të gjitha fondet, aktivet financiare dhe burimet e tjera ekonomike që i përkasin, zotërohen ose mbahen nga një person fizik ose juridik, një grup ose një subjekt i përfshirë në listën e përmendur në paragrafin 3;

b) fondet, aktivet financiare dhe burimet e tjera ekonomike nuk vihen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në dispozicion ose në dobi të një personi fizik ose juridik, një grupi ose një subjekti të përfshirë në listën e përmendur në paragrafin 3.

2. Përveç siç lejohet nga neni 5 dhe 6, ndalohet ofrimi i shërbimeve financiare për ose në dobi të një personi fizik ose juridik, një grupi ose një subjekti të përfshirë në listën e përmendur në paragrafin 3.

3. Këshilli përcakton rishikon dhe ndryshon me unanimitet listën e personave, grupeve dhe subjekteve për të cilat zbatohet kjo rregullore, në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 1, paragrafët 4, 5, dhe 6 të Qëndrimit të Përbashkët 2001/931/PPJS; lista përmban:

I. personat fizikë që kryejnë ose përpiqen të kryejnë, që marrin pjesë apo që ndihmojnë në kryerjen e ndonjë akti terrorist;

II. personat juridikë, grupet ose subjektet që kryejnë ose përpiqen të kryejnë, që marrin pjesë apo që ndihmojnë në kryerjen e ndonjë akti terrorist;

III. personat juridikë, grupet ose subjektet që zotërohen apo kontrollohen nga një ose më shumë persona fizikë ose juridikë, grupe apo subjekte të përmendura në pikat I. dhe II.; ose

IV. personat fizikë ose juridikë, grupet ose subjektet që veprojnë nën drejtimin ose për llogari të një ose më shumë personave fizikë ose juridikë, grupeve apo subjekteve të përmendura në pikat I. dhe II.

Neni 3

1. Ndalohet pjesëmarrja e vetëdijshme dhe e qëllimshme në aktivitete, qëllimi apo efekti i të cilave konsiston në shmangien direkte ose indirekte të nenit 2.

2. Çdo informacion që tregon se po shmangen apo janë shmangur dispozitat e kësaj rregulloreje i bëhet i ditur autoriteteve kompetente të shteteve anëtare të renditura në shtojcë dhe Komisionit.

Neni 4

1. Pa cenuar rregullat e zbatueshme për raportimin, konfidencialitetin dhe sekretin profesional dhe dispozitat e nenit 284 të traktatit, bankat, institucionet e tjera financiare, kompanitë e sigurimit, si dhe organet dhe personat e tjerë:

- japin menjëherë çdo informacion që mund të lehtësojnë përputhshmërinë me këtë rregullore, si p.sh. llogaritë dhe shumat e ngrira në përputhje me nenin 2 dhe transaksionet e ekzekutuara sipas neneve 5 dhe 6:

- autoriteteve kompetente të shteteve anëtare të renditura në shtojcë në të cilat janë vendosur apo ndodhen ato, dhe

- nëpërmjet këtyre autoriteteve kompetente, Komisionit;

- bashkëpunojnë me autoritetet kompetente të renditura në shtojcë për verifikimin e këtij informacioni.

2. Çdo informacion i dhënë ose i marrë në përputhje me këtë nen përdoret vetëm për qëllimet për të cilat ai është dhënë apo marrë.

3. Çdo informacion i marrë drejtpërdrejtë nga Komisioni vihet në dispozicion të autoriteteve kompetente të shtetit anëtar në fjalë dhe Këshillit.

Neni 5

1. Neni 2, paragrafi 1, germa "b" nuk zbatohet për shtimin, në llogaritë e ngrira, të interesave të këtyre llogarive. Interesat ngrihen gjithashtu.

2. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare të renditura në shtojcë mund të japin autorizime të veçanta, sipas kushteve që ato i gjykojnë të përshtatshme me qëllim parandalimin e financimit të akteve terroriste, për

1. përdorimin e fondeve të ngrira për të mbuluar, brenda BE-së, nevojat thelbësore të një personi fizik të përfshirë në listën e përmendur në nenin 2, paragrafi 3 ose të një anëtari të

familjes së tij, duke përfshirë në veçanti pagesat për ushqim, medikamente, qiranë ose hipotekën e banesës në të cilën jeton familja, si dhe tarifat dhe pagesat për trajtimin mjekësor të anëtarëve të familjes;

2. përdorimin e llogarive të ngrira për kryerjen e pagesa qëllimet e mëposhtme:

a) pagesat e tatimeve, primeve të sigurimit të detyrueshëm dhe tarifave për shërbimet publike, si gaz, ujë, energji elektrike dhe telekomunikacioni, të cilat duhet të kryhen brenda BE-së; dhe

b) pagesën e tarifave për mirëmbajtjen e llogarive ndaj një institucioni financiar në BE;

3. pagesat ndaj një personi, subjekti ose organizmi të përfshirë në listën e përmendur në nenin 2, paragrafi 3, sipas kontratave, marrëveshjeve ose detyrimeve të lidhura ose të lindura përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, me kusht që këto pagesa të kryhen në një llogari të ngrirë brenda BE-së.

3. Kërkesat për autorizime i paraqiten autoritetit kompetent të shtetit anëtar në territorin e të cilit janë ngrirë fondet, aktivet financiare ose burimet e tjera ekonomike.

Neni 6

1. Pavarësisht dispozitave të nenit 2 dhe me qëllim mbrojtjen e interesave të BE-së, të cilat përfshijnë interesat e shtetasve dhe të rezidentëve të atë shtet, autoritetet kompetente të një shteti anëtar mund të japin autorizime specifike për:

- shkrirjen e fondeve, aktiveve financiare dhe burimeve të tjera ekonomike;

- vënien e fondeve, aktiveve financiare dhe burimeve të tjera ekonomike në dispozicion të një personi, subjekti ose organi të përfshirë në listën e përmendur në nenin 2, paragrafi 3, ose

- ofrimin e shërbimeve financiare një personi, subjekti ose organi të tillë;

pas konsultimit me shtetet e tjera anëtare, Këshillin dhe Komisionin, në përputhje me paragrafin 2.

2. Autoriteti kompetent që merr një kërkesë për autorizim sipas paragrafit 1 u njofton autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare, Këshillit dhe Komisionit që renditen në shtojcë arsyet për të cilat ai synon që refuzojë kërkesën apo të japë një autorizim specifik, duke iu bërë të ditur kushtet që i gjykon të nevojshme për parandalimin e financimit të akteve të terrorizmit.

Autoriteti kompetent që synon të japë një autorizim specifik merr në konsideratë komentet e bëra brenda dy javëve nga shtetet e tjera anëtare, Këshilli dhe Komisioni.

Neni 7

Komisioni ka kompetencën për të ndryshuar shtojcën në bazë të informacionit të marrë nga shtetet anëtare.

Neni 8

Shtetet anëtare, Këshilli dhe Komisioni informojnë njëri-tjetrin për masat e marra sipas kësaj rregulloreje dhe shkëmbejnë informacionet përkatëse që disponojnë në lidhje me këtë rregullore, kryesisht informacionet e marra në përputhje me nenet 3 dhe 4, si dhe informacionin mbi shkeljet, problemet në zbatimin e saj ose vendimet e gjykatave kombëtare.

Neni 9

Çdo shtet anëtar vendos sanksionet që do zbatohen për shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje. Këto sanksionet duhet të jenë efikase, proporcionale dhe shtrënguese.

Neni 10

Kjo rregullore zbatohet:

1. në territorin e BE-së, duke përfshirë hapësirën e saj ajrore;
2. në bordin e çfarëdo avioni ose anijeje që është në juridiksionin e një shteti anëtar;
3. për këdo në një vend tjetër çfarëdo, i cili është shtetas i një shteti anëtar;
4. për çdo person juridik, grup ose subjekt të themeluar ose të krijuar sipas legjislacionit të një shteti anëtar;
5. për çdo person tjetër juridik, grup ose subjekt që ushtron veprimtari brenda BE-së.

Neni 11

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Evropiane.

2. Komisioni, brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, paraqet një raport për ndikimin e rregullores dhe, nëse është e nevojshme, bën propozime për ndryshimin e saj.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha shtetet anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 27 dhjetor 2001.

Për Këshillin

Presidenti

L. Michel

SHTOJCË

LISTA E AUTORITETEVE KOMPETENTE TË PËRMENDURA NË NENET 3, 4 DHE 5

BELGJIKË

Ministère des finances Trésorerie avenue des Arts 30 B - 1040 Bruxelles Fax (32-2) 233
75 18

DANIMARKË

Erhvervsfremmestyrelsen Dahlerups Pakhus

Langelinie Alle 17

DK - 2100 København Ø Tel. (45) 35 46 60 00 Fax (45) 35 46 60 01

GJERMANI

- për ngrirjen e fondeve: Deutsche Bundesbank Wilhelm Eppsteinstr. 14 D - 60431
Frankfurt/Main Tel. (00-49-69) 95 66

- për sigurimet: Bundesaufsichtsamt für das Versicherungswesen (BAV) Graurheindorfer
Str. 108 D - 53117 Bonn Tel. (00-49-228) 42 28

GREQI

Ministry of National Economy General Directorate of Economic Policy 5 Nikis str. GR -
105 63 Athens Tel. (00-30-1) 333 27 81-2 Fax (00-30-1) 333 27 93

Υπουργείο Εθνικής Οικονομίας Γενική Διεύθυνση Οικονομικής Πολιτικής Νίκης 5,
10562 ΑΘΗΝΑ Τηλ.: (00-30-1) 333 27 81-2 Φαξ: (00-30-1) 333 27 93

SPANJË

Dirección General de Comercio e Inversiones

Subdirección General de Inversiores Exteriores

Ministerio de Economía Paseo de la Castellana, 162 E - 28046 Madrid Tel. (00-34) 91
349 39 83 Fax (00-34) 91 349 35 62

Dirección General del Tesoro y Política Financiera

Subdirección General de Inspección y Control de Movimientos de Capitales

Ministerio de Economía Paseo del Prado, 6 E - 28014 Madrid Tel. (00-34) 91 209 95 11
Fax (00-34) 91 209 96 56

FRANCË

Ministère de l'économie, des finances et de l'industrie Direction du Trésor

Service des affaires européennes et internationales

Sous-direction E

139, rue du Bercy F - 75572 Paris Cedex 12 Tel. (33-1) 44 87 17 17 Fax (33-1) 53 18 36

15

IRLANDË

Central Bank of Ireland Financial Markets Department PO Box 559 Dame Street Dublin
2 Tel. (353-1) 671 66 66

Department of Foreign Affairs

Bilateral Economic Relations Division

76-78 Harcourt Street Dublin 2 Tel. (353-1) 408 24 92

ITALI

Ministero dell'Economia e delle Finanze ...

LUKSEMBURG

Ministère des affaires étrangères, du commerce extérieur, de la coopération, de l'action
humanitaire et de la défense Direction des relations économiques internationales BP 1602 L -
1016 Luxembourg Tel. (352) 478-1 ou 478-2350 Fax (352) 22 20 48

Ministère des Finances 3 rue de la Congrégation L - 1352 Luxembourg Tel. (352) 478-
2712 Fax (352) 47 52 41

HOLANDË

Ministerie van Financiën Directie Wetgeving, Juridische en Bestuurlijke Zaken Postbus
20201 2500 EE Den Haag Nederland Tel. (31-70) 342 82 27 Fax (31-70) 342 79 05

AUSTRI

- Neni 3 Bundesministerium für Inneres - Bundeskriminalamt A - 1090 Wien Josef-
Holaubek-Platz 1 Tel. (+ 431) 313 45-0 Fax (431) 313 45-85 290

- Neni 4 Oestereichische Nationalbank A - 1090 Wien Otto-Wagner-Platz 3 Tel. + 431)
404 20-0 Fax (431) 404 20-73 99 Bundesministerium für Inneres - Bundeskriminalamt A - 1090
Wien Josef-Holaubek-Platz 1 Tel. (+ 431) 313 45-0 Fax (431) 313 45-85 290

- Neni 5 Bundesministerium für Inneres - Bundeskriminalamt A - 1090 Wien Josef-Holaubek-Platz 3 Tel. (+ 431) 404 20-0 Fax (431) 404 20-73 99

PORTUGALI

Ministério das Finanças Direcção Geral dos Assuntos Europeus e Relações Internacionais Avenida Infante D. Henrique, n.o 1, C 2.o P - 1100 Lisboa Tel.: (351-1) 882 32 40/47 Fax: (351-1) 882 32 49

Ministério dos Negócios Estrangeiros Direcção Geral dos Assuntos Multilaterais/Direcção dos Serviços das Organizações Políticas Internacionais Largo do Rilvas P - 1350-179 Lisboa Tel.: (351 21) 394 60 72 Fax: (351 21) 394 60 73

FINLANDË

Ulkoasiainministeriö/Utrikesministeriet PL 176 SF - 00161 Helsinki Tel. (358-9) 13 41 51 Fax. (358-9) 13 41 57 07 dhe (358-9) 62 98 40

SUEDI

- Neni 3 Rikspolisstyrelsen (RPS) Box 12256 102 26 Stockholm tfn 08-401 90 00 fax 08-401 99 00

- Neni 4 dhe 6 Rikspolisstyrelsen (RPS) Box 7831 103 98 Stockholm tfn 08-787 80 00 fax 08-24 13 35

Neni 5 Riksförsäkringsverket (RFV) 103 51 Stockholm tfn 08-786 90 00 fax 08-411 27 89

MBRETËRI E BASHKUAR

HM Treasury International Financial Services Team 19 Allington Towers London SW1E 5EB United Kingdom Tel: (44-207) 270 55 50 Fax: (44-207) 270 43 65

Bank of England Financial Sanctions Unit Threadneedle Street London EC2R 8AH United Kingdom Tel. (44-207) 601 46 07 Fax (44-207) 601 43 09

KOMUNITETI EVROPIAN

Commission of the European Communities Directorate-General for External Relations

Directorate CFSP

Unit A.2/Mr A. de Vries

Rue de la Loi/Wetstraat 200 B - 1049 Bruxelles/Brussel Tel.: (32-2) 295 68 80 Fax: (32-2) 296 75 63 Email: anthonius-de-vries@cec.eu.int

1. Shih faqen 93 të kësaj Gazete Zyrtare.
 2. Opinioni i dërguar më 13 dhjetor 2001 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare).
 3. *Gazeta Zyrtare L 67, 9.3.2001, f. 1.*
-